

**Metamorfoza e diskursit letrar pas vitit 1945:
dominimi i terminologjisë ideologjike
dhe varfërimi i ligjërit kritik**

**Metamorphosis of literary discourse after the year 1945.
The domination of ideologic terminology and
the impoverishing critical discourse**

Abstract: *This paper focuses on the metamorphosis of literary discourse in Albania after 1945, a shift which becomes even more evident when compared with the terminology employed in the literary discussions of the 1930s and 1940s. The study highlights how debates, reviews, and criticism of the period were reshaped through the installation of an ideological vocabulary that gradually supplanted literary terminology, thus resulting in dominance of theoretical and critical literary thought. Political tools became criteria of literary evaluation; subversive methods were employed to set authors against authors, works against works, and literary streams against one another. The literary system was emptied of names and models that had previously established paradigms, leading to an impoverishment of literary debate and its reduction to deeply ideological and authoritative discourses, thus institutionalizing the new course that literature would take.*

Grounded in Pierre Bourdieu's concept of the cultural field and Louis Althusser's notion of the ideological state apparatuses, this study examines how political power intervened in the Albanian literary field. Drawing on periodicals and reviews of the time, the study also demonstrates how censorship and self-censorship functioned as mechanisms of internal discipline, transforming the writer into an ideological functionary and literary-critical discourse into a tightly controlled form of expression.

Keywords: *Critical thought, Literary discourse, Ideological discourse, Cultural field, Pierre Bourdieu, Louis Althusser.*

1. HYRJE TEORIKE E STUDIMIT

Analiza e marrëdhënies midis letërsisë dhe pushtetit politik në Shqipërinë e pas Luftës së Dytë Botërore kërkon një qasje ndërdisiplinore, që e tejkalon vështrimin tradicional tematik apo formalist të teksteve letrare. Në kushtet e një regjimi totalitar, letërsia nuk funksionon më si

një hapësirë autonome estetike, por si një fushë e përshkruar thellësisht nga logjika ideologjike dhe strukturat e pushtetit. Ky pozicion kërkon një aparat teorik të gjerë, i cili ndihmon për të analizuar mënyrat konkrete në të cilat diskursi letrar është nënshtruar, kanalizuar dhe instrumentalizuar nga pushteti politik në Shqipëri.

Në këtë drejtim, koncepti i “*regjimit të së vërtetës*” i zhvilluar nga Michel Foucault (1980, 1995) shërben si pikënisje për të kuptuar sesi pushteti prodhon dhe kontrollon dijen. Foucault argumenton se çdo regjim politik ngre një sistem të prodhimit të “*së vërtetës*”, duke përcaktuar se cilat diskurse lejohen dhe cilat përjashtohen.¹

Në rastin shqiptar, diskursi ideologjik i regjimit komunist ndërhyri fuqishëm mbi diskursin letrar, duke zëvendësuar kriterin estetik me atë politik dhe duke e kthyer letërsinë në një instrument të të vërtetës ideologjike.² Vendosja e diskursit ideologjik mbi atë estetik u krye jo vetëm nëpërmjet aparateve represive të shtetit, por edhe nëpërmjet asaj që Louis Althusser (1971)³ e quan *Ideological State Apparatuses*⁴ (aparartet ideologjike të shtetit) (ISA). Këto institucione - si shkolla, kisha, media, familja dhe kultura (përfshirë edhe letërsinë) - funksionojnë përmes ideologjisë, e jo përmes dhunës, duke garantuar riprodhimin e marrëdhënieve të prodhimit nëpërmjet formimit të individëve si subjekte në përputhje me ideologjinë sunduese.⁵ Këto veprojnë në mënyrë më

1 M. FOUCAULT, (1980). *Power/Knowledge: Selected Interviews and Other Writings 1972–1977*. Pantheon, f. 131. «Each society has its regime of truth, its ‘general politics’ of truth: that is, the types of discourse which it accepts and makes function as true; the mechanisms and instances which enable one to distinguish true and false statements, the means by which each is sanctioned; the techniques and procedures accorded value in the acquisition of truth; the status of those who are charged with saying what counts as true. » see also M. FOUCAULT, (1995). *Discipline and Punish: The Birth of the Prison*. Vintage. f. 37.

2 Diskursi letrar kuptohet si hapësira e ndërveprimit simbolik ku shkrimtarë, kritikë, studiues dhe institucione konkurrojnë për të përcaktuar vlerën, kuptimin dhe legjitimitetin e veprës letrare. Ai përfaqëson shprehjen ligjërimore të marrëdhënieve që ndërtohen brenda fushës letrare dhe reflekton shkallën e autonomisë ose të varësisë së saj ndaj fushave të tjera të pushtetit, veçanërisht ndaj fushës politike.

3 Filozofi francez Louis Althusser (1918–1990), megjithëse në artikullin e tij *Ideology and Ideological State Apparatuses (Notes towards an Investigation)* shkruan në kontekstin e kritikës së kapitalizmit nga një pozitë marksiste dhe paraqet koncepte që shpjegojnë mekanizmat e riprodhimit të marrëdhënieve të prodhimit dhe funksionimin e aparateve ideologjike të shtetit, në këtë kontekst, teoria e tij dhe nocionet që ai propozon mund të aplikohen po aq mirë edhe në sistemet socialiste-komuniste, duke mundur kritikën e tyre “nga brenda”.

4 Shih: L. ALTHUSSER, (1971). *Ideology and Ideological State Apparatuses (Notes towards an Investigation)*. In *Lenin and Philosophy and Other Essays*, B. Brewster, Trans., Monthly Review Press. ff. 127–186).

5 Po aty, 1971, «It is in the forms and under the forms of ideological subjection that

të butë se aparatet represive të shtetit, por jo më pak të efektshme në formësimin e bindjeve dhe të sjelljeve.⁶

Në Shqipërinë e pas vitit 1945, letërsia, kritika, tekstet shkollore dhe organet botuese u konvertuan në aparate të këtij lloji, duke përforcuar rolin e shkrimtarit si edukator i masave dhe garant i vijës partiake. Kështu, shkrimtari, artisti nuk ishte më thjesht autor, por duhet të shihej si një *funksionar ideologjik*, që prodhonte diskurse të miratuara politikisht.

Për të kuptuar metamorfozën që pësoi letërsia shqiptare pas vitit 1945, është e domosdoshme të shihet se si pushteti politik ndikoi në transformimin e saj nga një sistem letrar me një autonomi relative - i cili, deri në atë kohë, kishte nisur të konsolidohej mbi bazën e diversitetit të zërave kritikë dhe të konkurrencës estetike - në një mekanizëm të instrumentalizuar, në një aparat ideologjik të shtetit. Në këtë kuadër, i referohemi konceptit të Pierre Bourdieu-së mbi fushën kulturore (*champ culturel*)⁷. Fusha kulturore, e cila në parim karakterizohet nga hapësira e autonomisë relative⁸ që u mundëson aktorëve kulturorë - shkrimtarëve, kritikëve, botuesve, artistëve - të konkurrojnë për kapital simbolik, prestigj, autoritet dhe legjitimitet kulturor; në Shqipërinë e pasluftës kjo u tkurr në mënyrë drastike. Pas vitit 1945, ndërhyrja e ideologjisë dhe politikës jo vetëm që e komprometoi këtë autonomi, por edhe e zëvendësoi atë me një logjikë të kontrollit ideologjik, ku kriteret estetike u nënshtroheshin kriterëve politike dhe ku diskursi letrar u shndërrua në një monolog të kushtëzuar nga pushteti. Artisti vetë nuk është më individ, por pjesë e një mekanizmi që ndërton dhe shpreh të vërtetën e pranuar.⁹

provision is made for the reproduction of the relations of production, through the reproduction of submission to the ruling ideology. In this way, all ideology functions to constitute concrete individuals as subjects, ensuring their alignment with the dominant order. » ff. 132–133, 170

6 Po aty, f. 133.

7 P. BOURDIEU, (1993). *The Field of Cultural Production: Essays on Art and Literature*. Columbia University Press., f. 39.

8 Po aty, f. 30. «...a relatively autonomous space of social positions and struggles, governed by specific rules and forms of capital, such as symbolic or cultural capital. »

9 Sipas BOURDIEU, në *The Rules of Art; Genesis and Structure of the Literary Field*. 1996, fusha letrare/kulturore ndahet në dy pole: Poli autonom – ku vlerat estetike mbizotërojnë dhe krijimtaria i bindet vetëm “logjikës së artit për art”. Poli heteronom – ku ndikimi i faktorëve ekonomikë, politikë apo ideologjikë është i fortë dhe ku arti instrumentalizohet. “Every field develops its own nomos, its own law, but this autonomy is always relative and subject to threats from more powerful fields such as politics or economics.” (BOURDIEU, 1996, *The Rules of Art*, f. 215) Sipas këtij modeli, shkrimtarët nuk konkurronin më mbi baza estetike, por mbi besnikërinë ideologjike dhe afërsinë me pushtetin, çka në vazhdimësi deformoi hierarkitë brenda fushës. Në Shqipëri, autorët që zotëronin “kapital politik” ishin të privilegjuarit e sistemit, ndërsa ata me kredenciale estetike, por me qëndrime kritike ndaj regjimit përjashtoheshin

Kjo kornizë teorike gjen plotësim në analizën e modelit estetik dhe politik të realizmit socialist, i artikuluar si politikë kulturore nga Andrei Zhdanov (1950) dhe i përpunuar teorikisht nga György Lukács (1969). Në doktrinën zhdanoviane, letërsia duhej të ishte “partiake në përmbajtje” dhe “realiste në formë”, duke pasqyruar realitetin nga një këndvështrim revolucionar dhe duke shërbyer si mjet edukimi ideologjik.¹⁰ Lukács e mbështeti këtë qasje duke theksuar rëndësinë e tipizimit dhe të paraqitjes së konfliktit shoqëror në mënyrë që të përforcohej vizioni i së ardhmes socialiste.¹¹ Në këtë kuadër, shkrimtari dhe kritiku shqiptar nuk ishin më subjekt estetik të lirë, por “funksionarë ideologjikë” të integruar në aparatin e prodhimit kulturor të shtetit, ku gjykimi dhe krijimtaria individuale kufizohej nga detyrimi për të përmbushur objektiva të qarta ideologjike.

Në regjimet autoritare, instancat e kontrollit mbi letërsinë nuk funksionojnë vetëm si mekanizma të jashtëm, por shndërrohen në procese të brendshme që ndikojnë drejtpërdrejt mënyrën se si kritikët

apo heshteshin. Shembuj në letërsinë shqipe ka plot, më domethënësit janë Lasgush Poradecit, Mitrush Kuteli, Kasem Trebeshin. Frederik Rreshpja.

- 10 Në Shqipërinë e pas Luftës së Dytë Botërore, roli i letërsisë u përcaktua brenda një kornize strikte të realizmit socialist, një doktrinë estetike dhe politike që gjeti bazamentin e saj teorik në ndërhyrjet ideologjike të Andrei Zhdanov dhe reflektimet estetike të György Lukács. Andrei Zhdanov, në fjalimet e tij të mbledhjes së Shkrimtarëve Sovjetikë në vitin 1934 dhe në tekstet e përmbledhura më pas në veprën *On Literature, Music and Philosophy* (1950), e përcakton qartë qëllimin e letërsisë nën socializëm: “Arti dhe letërsia duhet të bëhen armë në duart e proletariatit për ndërtimin e socializmit” (ZHDANOV, 1950, f. 12). Sipas tij, shkrimtari nuk mund të jetë më një vëzhgues i lirë i realitetit; ai duhet të jetë një edukator i ndërgjegjes së masave, duke pasqyruar realitetin jo siç është, por siç duhet të jetë në funksion të ndërtimit të socializmit. Zhdanovi thekson se letërsia nuk mund të shfaqë dyshime, pesimizëm apo forma “dekadente” të shprehjes, sepse: “*Ne kërkojmë optimizëm revolucionar, ne kërkojmë heronj që mishërojnë virtytet më të mira të shoqërisë socialiste.*” (ZHDANOV, 1950, f. 18). Kjo kërkesë e drejtpërdrejtë për optimizëm revolucionar është një ndër shtyllat themelore që e shndërron shkrimtarin në një funksionar të ideologjisë, duke e zhveshur nga autonomia e tij krijuese. Shih: A. ZHDANOV, (1950). *On Literature, Music and Philosophy*. Foreign Languages Publishing House.

- 11 Nga ana tjetër, György Lukács, në veprën e tij *The Meaning of Contemporary Realism* (1969), i jep një formulim më të sofistikuar estetik idesë së realizmit. Edhe pse më nuancues se Zhdanov, Lukácsi mbetet besnik ndaj një ideje thelbësore: realizmi duhet të kapë “të vërtetën historike” të proceseve shoqërore, përtej pamjes sipërfaqësore të ngjarjeve. Ai shkruan: “*Detyra e artit realist është të zbulojë tendencat objektive të zhvillimit historik, edhe kur ato nuk janë ende të dukshme për vetë subjektet e historisë.*” (LUKÁCS, 1969, f. 18). Sipas Lukácsit, realizmi socialist është superior ndaj formave moderniste të artit pikërisht, sepse synon një pasqyrim tipizues të realitetit, duke nxjerrë në pah ligjësitë e zhvillimit social, dhe jo thjesht fragmentet e jetës së përditshme. Në këtë mënyrë, edhe Lukács, ndonëse me më shumë rafinim teorik se Zhdanov, e sheh shkrimtarin si të lidhur ngushtë me misionin ideologjik të pasqyrimit të realitetit revolucionar dhe të afirmimit të rrugës së socializmit. G. LUKÁCS, (1969). *The Meaning of Contemporary Realism*. Merlin Press.

dhe krijuesit mendojnë, shkruajnë dhe vetëpozicionohen brenda fushës kulturore-letrare. Në këto rrethana, krijuesit dhe kritikët veprojnë brenda një forme të institucionalizuar disiplinimi të brendshëm, e cila parashikon dhe paraprkasht shmang çdo devijim nga norma ideologjike e pranuar. Siç ka vërejtur Robert Darnton¹², pjesa më e rëndësishme e këtij procesi për krijuesit ishte autocensura — një mekanizëm i padukshëm, por thelbësor, që nuk linte gjurmë në arkiva. Shkrimtari gjerman Erich Loest¹³ e ka përshkruar këtë gjendje si praninë e një “njeriu të vogël jeshil në vesh”, një zë i brendshëm paralajmërues që filtron çdo fjali sipas normës ideologjike, që zhvillon një “ekonomi të tërthortë komunikimi.”¹⁴ Ky proces krijonte një ligjërim të dyfishtë: një shtresë të dukshme dhe të pranueshme për censurën zyrtare, dhe një tjetër, të nënkuptuar, për lexuesin e vëmendshëm.

15

Kjo dinamikë e brendshme censurës dhe e autocensurës përshkruhet me saktësi nga Pierre Bourdieu (1996)¹⁶ dhe këtë mekanizëm ai e shpjegon si përshtatjen e diskursit të autorit ndaj një “horizonti të pritshëm” të përcaktuar nga pushteti.

Në këtë kuadër, analiza me qasje teorike, e mbështetur në shqyrtimin e këndvështrimeve mbi letërsinë – duke u ndalur në modelin e kritikave, recensioneve, diskutimeve e debateve të botuara në shtypin periodik dhe revistat e kohës – ofron bazën për të shqyrtuar mënyrën se si diskursi ideologjik i pas vitit 1945 e shndërroi fushën letrare, përmbajtjen dhe funksionin e letërsisë, si dhe rolin e autorit. Në plan metodologjik, ky studim mbështetet në një qasje cilësore të analizës së diskursit, të ndërthurur me perspektivën e sociologjisë së letërsisë. Korpusi përbëhet nga artikuj kritikë, recensione, debate letrare dhe shënime programatike

12 R. DARNTON. «Communist East Germany: Planning and Persecution» në *Censors at Work: How States Shaped Literature*. London: W.W.Norton. 2015, f. 182-191.

13 «Yet the most important part of the process is the most difficult to identify, because it happened in the author's head. Self-censorship left few traces in the archives, but East Germans often mentioned it, especially when they felt free to talk after the fall of the Wall. In *Der Zorn des Schafes (The anger of the sheep)*, 1990), for example, Erich Loest explained that in 1950, when he began his career as a writer and enjoyed an uncritical faith in the legitimacy of the regime, he had no difficulty in accepting censorship, because he could not imagine treating any subject in any way that would damage the cause of socialism. But after three decades of trimming his prose to the demands of editors, publishers, and the HV, he emigrated to West Germany; and when he resumed writing in the FRO, he realized that an inner voice had been whispering to him all along, at every line he wrote, “Careful, that can cause you trouble!” He called it “that little green man inside the ear.» Shih: DARNTON, f. 184.

14 Po aty, f. 183.

15 Po aty, f. 184.

16 P. BOURDIEU, (1996). *The Rules of Art: Genesis and Structure of the Literary Field*. Stanford: Stanford University Press.

të botuara në periodikët letrarë e kulturorë shqiptarë gjatë viteve 1945-1965, me fokus te revistat *Literatura jonë*, *Bota e re* dhe *Nëntori*. Për qëllime krahasuese janë marrë në shqyrtim edhe shkrime kritike të viteve 1930-1944, të cilat shërbejnë si pikë referimi për evidentimin e ndryshimeve në terminologji, në kriteret e vlerësimit dhe në funksionin e kritikës letrare. Analiza përqendrohet në mënyrën se si diskursi mbi letërsinë ndërton kategori vlerësimi, modele autorësh dhe hierarki estetike e ideologjike, duke u mbështetur në konceptin e fushës kulturore të Pierre Bourdieu-së dhe në nocionin e aparateve ideologjike të shtetit të Louis Althusser-it.

2. DISKURSI IDEOLOGJIK DHE ZBRAZJA E SISTEMIT LETRAR NË TRAJTESAT MBI LETËRSINË E PAS 1945-S

Në funksion të punimit, por edhe për hir të kontrastit - për të kuptuar më mirë si qenë dhe si u zhvilluan diskutimet mbi letërsinë para kohës që kemi marrë si objekt - le të na lejohet të sjellim në vëmendje situatën e diskutimit letrar në shkrimet (debate, diskutime, recensa a kritika) gjatë viteve '30-'40. Ose edhe vetëm gjatë gjysmës së parë të '40.

Emrat e Namik Resselit [1908-1985], Filip Fishtës [1904-1973], Arshi Pipës [1920-1997], Kolë Ashtës [1918-1998], Pashko Gjeçit [1918-2010], Mitrush Kutelit [1907-1967], Vangjel Koçes [1900-1943], Eqrem Çabejt [1908-1980], Sterjo Spases [1914-1989], Vedat Kokonës [1913-1998], Kristo Dakos [1880 - 1941], Qemal Draçinit [1922-1947], Ernest Koliqit [1901 -1975] do të shënojnë pjesën më të madhe të artikujve për problematika të ndryshme letrare, nga ato të funksionit estetik të artit/letërsisë¹⁷, diskutimet e polemikat për çështje të thelluara teoriko-letrare¹⁸ e deri te çështje që kanë të bëjnë me natyrën dhe format që i duhen kritikës¹⁹, te trajtesa në formë kritikash e recensionesh për vepra e autorë

17 Shih shkrimet e Nebil Çikës, te gazeta "Bashkimi i Kombit" të vitit '44, në lidhje me përkufizimin e së bukurës si kategori estetike;

N. ÇIKA, 1944. «Ç'është e bukura ose ç'është bukurija? » *Bashkimi i kombit*, 25 qershor.

—. 1944. «Natyra dhe cilësitë e bukurisë. » *Bashkimi i kombit*, 1 Korrik.

—. 1944. «Rreth kuptimit të Bukurisë (Ç'është bukurija?). » *Bashkimi i kombit*, 28 qershor; dhe shkrimet e Lek Drinit në gazetën "Tomori" të viteve '42-'43, "Arti i ri dhe kufijt e tij", "Si shikon poeti", "Futurizmi dhe kujtimi"

L. DRINI, 194_. «Arti si përpjekje. Lodra dhe endëra (Rreth artit).» *Tomori*, 13 janar.

—. 1942. «Futurizmi dhe kujtimi.» *Tomori*, 23 janar.

—. 1942. «Kujtimi element i parë i artit.» *Tomori*, 28 janar.

—. 1942. «Si shikon poeti (studime estetike).» *Tomori*, 7, 10, 17 korrik

18 T. KUQALI «Problema t'ona letrare», *Tomorri i vogël*, Tiranë 1942, nr. 14-15, f. 5; Jani Lili «Shënime kritike/ të dy rrymat», *Fashizmi*, Tiranë, dhjetor 1939; «Mendime mbi letërsisë», *Tomorri*, Tiranë, gusht 1940 «Poezia- Proza», *Fashizmi*, Tiranë shkurt 1940, f. 3 etj, etj.

19 Shkrimet e Kolë Ashtës «Për një kritikë të poezis» te *Drita*, Tiranë, 12 janar 1939 , f.3, «Çashje mbi çashtje», te *Shkëndija*, 1943, v.III, nr. 11, ff. 1-3; Muhamet Bala « A kemi një

konkretë²⁰. Këtu mund të kujtojmë debatin mes Prof. Rresulit dhe Prof. Fishtës për çështjen e periodizimit të letërsisë; polemikën e V. Koçës me prof. Fishtën për çështjen e zhvillimit të novelës dhe kontributit të Koliqit në të, shkrimet e vetë Koliqit, Ashtës, Çabejt e Pipës për Gjergj Fishtën; trajtesat në formë kritike, recensionit të Kutelit, të botuara te *Shënime letrare* e *Revista letrare*, janë të gjitha të ngritura në sferën e letrares.

Por ky diskurs do të mbyllet këtu. Nuk do të vazhdojë më gjatë as ngritja e argumenteve dhe parashtrimi i tyre nga perspektiva e letrares, as prania e emrave të mësipërm. Pas '44, me një rezistencë të lehtë të mendimit letrar ndaj atij politik (nëse mund të quhet rezistencë periudha kur Malëshova orientonte politikën kulturore të revistës *Bota e re*),²¹ atmosfera e diskutimeve mbi krijimin letrar, letërsinë dhe krijuesin do të ngarkohet me një gjuhë ideologjike diktuese. Në numrin e parë të revistës "Literatura jonë", në shënimin e redaksisë, njëherazi e lexuar edhe si strategjia e shtetit ndaj letërsisë, do të projektohen kërkesat ndaj shkrimtarit dhe letërsisë "së re"²². Nga këto kërkesa do të përvijohet edhe modeli i letërsisë dhe shkrimtarit "të pranuar" dhe, në antonimi me të, edhe i atij "të përjashtuar".

— I pari - i angazhuar politikisht me ideologjinë e kohës, me tema të

dram modern shqiptar», *Kultura Islame*, 1942 nr 5,6,7, Kallnuer-Shkurt Koliqi «Malli i shtampës» rev. *Shkëndija* nr. 2, Tiranë, 1940, ff. 25-27, Arshi Pipa «Kritikë a polemikë», «Për një kritikë letrare», *Shkëndija*, nr. 2-3, 1941, ff. 59-61; Fadil Podgorica «Për një sistem të kritikës letrare» rev. *Fryma*, nr. 6, Shkodër, 1944, ff. 241-245 etj., etj.

20 Edhe debati, përse i përket çështjes së periodizimit të letërsisë në mes prof. Namik Rresulit e prof. Filip Fishtës, i cili prodhoi tri shkrime të njëpasnjëshme te revista *Shkëndija* (botuar te numrat 2, 3, 6, v. 1940 të kësaj reviste), do të ngrihej e përmbledhej brenda argumenteve (dhe kundërgjendimeve) letrare. Diskursi që i përcjell, do të ishte i sferës së letrares. Flitet për ndarje të letërsisë shqipe në dy periudha në bazë të qëllimisë estetike letrare të veprave dhe të ndikimit dhe përhapjes që ato kanë në periudhën letrare të mëpasme. Flitet për rrezatime kulturore në letërsinë e secilit dialekt, për orientime drejt dialektit gjuhë-formues në bazë të zhvillimeve letrare (teza e prof. Rresulit). Prof. Fishta parashtron kundërgjendimet, duke evidentuar e ilustruar përmasën e letrares edhe aty ku Rresuli, sipas tij, i vë në diskutim. Diskursit letrar i nënshtrohet edhe polemika në mes V. Koçës dhe prof. Fishtës e cila në thelb ka lidhje me zhvillimin e novelës në letërsinë shqipe dhe pozicionin e kontributit të Koliqit në të. Po ashtu, në hullitë e letrares janë shkrimet e Koliqit, Ashtës, Çabejt e Pipës për figurën e Gj. Fishtës botuar nën kujdesin e revistës *Shkëndija* në përmbledhjen me titull «Gjergj Fishta» 1941. Për të vazhduar me fuqizimin që ka ky diskurs në trajtesat në formë kritike dhe recensionit të Kutelit, të botuara te *Shënime letrare* e *Revista letrare* e '44.

21 S. MALËSHOVA, editoriali i revistës (1945, korrik). *Bota e re*, 1 (1), 46 (1).

22 Shikimi i çështjes së letërsisë si një problem me rëndësi për edukimin e masave popullore; përcaktimi i drejtimit letrar; konsiderimi i traditës si një trashëgimi që duhet skanuar nëpërmjet filtrave ideologjikë; anatemi i formatit të krijesit të lirë, atij të vërtetit, që besonte te arti në vetvete.

përcaktuara nga lufta e jeta e me misionin e edukuesit të masave (ironikisht i përcaktuar me termin *shkrimtar i mirë dhe popullor!!!*)

— I dyti - ai i shkrimtarëve “reaksionarë”, “indiferentë” e “apolitikë” që shkruajnë pa ndonjë qëllim, pa ideal, po vetëm për hir të artit ²³.

Që në këtë numër sugjerohet strategjia e përjashtimit të autorëve të modelit të dytë, nëpërmjet metodës së kundërvënies “autorë me autorë” apo “autor me grup autorësh”.

Kështu nis e konsolidohet edhe e historia e gjymtimit të sistemit letrar shqiptar. Ligjërimi që përdoret duket si i huazuar nga sfera e llogoreve të luftës: *Tani s’është vetëm puna që këtyre t’u tregojmë vendin, por edhe të shuajmë gjurmët e tyre, të cilat në vënt që t’i shërbejnë popullit, e dëmtojnë atë pa masë.*²⁴

Mjeti me të cilin sugjerohet të realizohet është kritika dhe modeli letrar, po diskursi që përdoret i rri shumë larg kritikës letrare dhe modelit: *Ne do t’arrijmë të thyejmë dhe të dërmojmë frontin e vjetër duke e goditur me anë të kritikës... por edhe sidomos duke prodhuar e duke bërë të prodhohen vepra letrare që do të jenë të vlefshme për popullin.*²⁵

Po cilat janë format e kritikës dhe recensioneve që do të shfaqen në numrat e kësaj reviste dhe të tjerave që do ta ndjekin?

- Shkrimi i Dh. Shuteriqit për Migjenin.

Dhjetë vite pasi kishte botuar te “Përpyekja shqiptare” shkrimin interesant, me titull “Arti i Migjenit”, ku prerjet dhe gjykimet lidheshin drejtpërdrejt me aspekte të ndërtimit artistik të tekstit (rrjedhimisht edhe diskursi i referohej mjeshtërisë së përdorimit të asonancës, muzikalitetit të vargut, gjurmimit të gjuhës të figurave, sentimentit dhe imagjinatës)²⁶, gjykimi i Shuteriqit do të marrë një tjetër trajektore. I fortifikuar me instrumentet e kritikës ideologjike dhe militantizmin politik, në vend të shijes letrare, Shuteriqi i ‘48-tës veprën e Migjenit do të kalonte në filtër ideologjik:

- Së pari, për ta përdorur për kundërshti ndaj shkollës katolike të Shkodrës (modeli i pranimit për përjashtim). Insistimin për ta lexuar zgjedhjen e teknikës së vargut dhe emërtimin e përmbledhjes poetike si refuzim i Migjenit ndaj kësaj shkolle, do të shoqëronte me stilemat e ligjëritimit politik: *Kjo shkollë, kryesisht reaksionare dhe antipopullore, që kish patur sukseset e saj duke sulmuar popullin tonë... kish rënë në marazhin*

23 Editorial, *Literatura jonë*, 1 (1), 1947. ff. 10–11.

24 Po aty.

25 Po aty.

26 «Migjeni hoqi dorë nga teknika jonë klasike, e në vend të rimës përdori shpesh asonancën dhe i dha kësaj vendin e nderit në poezinë e vet », DH. SHUTERIQI, «Arti i Migjenit», rev. *Përpyekja shqiptare*, nr. 18, 24 dhjetor 1938.

e vargnimit siç e tregon mirë “Lahuta e Malcisë”, e botuar e plotë. Epigonët e saj si Vincens Prenushi e të tjerë që meritojnë pak të përmenden, ishin bërë të padurueshëm... Në dorë të Fishtës, Prendushit e Koliqit me shokë, vargjet tona, kur nuk ishin mbushur me një lëndë reaksionare, agresive, antipopullore e antihistorike, ishin bërë pare kallp...²⁷

Me të njëjtat stilema politike përforcohet kundërvënia e Migjenit me Fishtën: Me urrejtjen ndaj letërsisë konformiste dhe reaksionare të kohës në Shqipëri, ...Migjeni është hedhur në sheshin e vjershërisë, duke dashur të shkruajë vargje... të përkundërta, vargje mohuese të vargjeve të Fishtës me shokë.²⁸

- Së dyti, për ta përdorur si idhulltar e pararendës të metodës së re krijuese që po diktohej. Insistimi për të diktuar leximin e tekstit sipas vektorit ideologjik bëri që i gjithë arti i Migjenit të shihet brenda këtij udhëzuesi. Për ilustrim, i tillë është rasti kur një poezi e tërë... siç është poezia “Kangët e pakëndueme”, të shihet brenda vlerës ideologjike që iu dha vargjeve liri që filloi me lulzue... dhe ... e ndjej nga dielli alegorik valën. Pyetjet retorike që ngre Shuteriqi, s’janë veçse udhëzimi se si duhej të lexohej poezia: “Kjo ç’mund të jetë tjetër për Migjenin veç se socializmi triumfues, ç’mund të jetë tjetër ai *Diell alegorik* veç Bashkimi i madh Sovjetik”?

Konstantet ideologjike që do të shoqërojnë diskursin e përcaktimit të vlerës së artit janë të njëjta: *militant, revolucionar, popullor*: Me artin e tij *militant revolucionar ai këndonte për t’arthmen e vendit tonë, e arthme që do të sillnin shokët e tij komunistë, me besim te populli i tyre dhe kurdoherë të frymëzuar nga “Dielli i math i lirisë së “shekullit të ri” nga Bashkimi sovjetik”*.

Kur në fakt, siç thotë Pipa “Nuk ka asgjë në shkrimet e tij (Migjenit-V.O) që të çojë në këtë përfundim... ideologët e partisë e quajtën prekursor të realizmit socialist, sepse kishin shumë nevojë të mbanin si bajrak një figurë të tillë.”²⁹

- Modeli i kundërvënies autor/ autor nëpërmjet diskursit politik do të përcillet edhe te parashpresa që shoqëron botimin e parë që u bëhet poezive të Mjedjes pas ‘45. Parateksti që shoqëron shkrimin e autorit me initiale M. Nd. orienton edhe thelbin e zgjedhjes: zgjedhja është extra letrare. Bëhet e qartë se janë idetë përparimtare, pra jo arti i Mjedjes, që e kanë nxitur përzgjedhësin te tekstet.

27 *Literatura jonë*, v.II/ 1948 f.10

28 *Po aty*.

29 «Në mënyrë spekulative Migjeni është shpallur prej realizmit socialist shqiptar si paraardhës i tij. Nuk ka asgjë në shkrimet e tij që të çojë në këtë përfundim... ideologët e partisë e quajtën prekursor të realizmit socialist, sepse kishin shumë nevojë të mbanin si bajrak një figurë të tillë.» A. PIPA, *Contemporary Albanian Literature*, Columbia University Press, New York, 1991, f. 13.

Vendosja e Mjedjes (si pranim) përkundër Fishtës³⁰ (përjashtimi) bëhet me argumente socio-politike e propagandistike. Asgjë nga diskursi i letrares nuk shënjojnë përcaktime të tilla si: *Mjeda i qan hallin atdheut të okupuar nxit popullin në luftë... kundër Turqisë e jo kundër fqinjëve siç bën Fishta me shovinizmin e tij racist Mjeda ka besim te populli e jo te bejlerët dhe agallarët ... siç bënte Fishta me idetë prapanike feudo borgjeze ... Mjeda nuk e mbështet shpresën te fuqitë imperialiste për çlirimin e Shqipërisë siç bën Fishta te Lahuta e Malcisë...* Ideologema e Mjedjes përkundër asaj të Fishtës ndërton kështu edhe kriteret e pranimit tashmë në sistemin e ri letrar të autorëve të traditës.

Një model më vete paraqesin kritikën dhe recensionet që u bëhen veprave të prodhuara pas '45. Të gjitha pothuajse janë uniforme: evidentojnë në terma politikë vlerat e luftës, arritjet e reja që shkojnë përkundër drejtimeve të mëparshme "reaksionare". Këtë situatë, edhe procesin e të shkruarit, Camaj do ta përmbledhë në mënyrë figurative kështu: *Më duket sikur këto mendime rrjedhin nga truni i autorëve si ushtarë që dalin në deviza të njillojta në hap, një mbas një prej kazërme*³¹.

- Shkrimi i Shuteriqit për librin "Uji fle, hasmi s'fle" të F. Gjatës, është një qasje e pastër ideologjike. Duke lënë mënjanë analizën që operon në fushë të fabulës së librit me termat e luftës së klasave, armiqitë e jashtëm, tipit të heronjve, veshjes ideologjike që duhet të bartin, lidhjes me masat etj., që ngjan si konspeksion i ligjëratave të Zhdanovit për letërsinë,³² do të sjellim në vëmendje vetëm paragrafin e parë, në të cilin merret në dukje me çështje letrare, por në të vërtetë përvijon qëndrimin politik të kohës ndaj letërsisë:

- së pari, me ripërcaktimin e termit novelë sipas terminologjisë ruse dhe këtë na e bën me dije kur sqaron se termin e njeh në kuptimin e rusishtes "povjest"³³. Shuteriqi zgjedh kështu t'i ikë përcaktimit klasik, të njohur përëndimor të stabilizuar si terminologji (dhe proces shkrimi) me kohë - që nga Bakaccio e deri te Gëte;

- së dyti, i njeh Gjatës (po ashtu edhe Dushit e Sakos)³⁴ statusin e inauguruesit të këtij lloji letrar në letërsinë shqipe³⁵, duke legjitimuar

30 Me këtë frymë do të jetë edhe shkrimi kritik «Vepra reaksionare e Fishtës», i cili që në titull përcakton natyrën e qasjes përjashtuese ndaj Fishtës dhe veprës së tij. *Letërsia jonë*, nr.2v. IV,1950) f.42.

31 M. CAMAJ «Nëpër fletët e "Nëndorit" ...», revista *Shejzat*, nr. 2-3, 1958.

32 Shih: A. ZHDANOV, (1950). *On Literature, Music and Philosophy. Foreign Languages*, Foreign Languages Publishing House., ff. 7-8.

33 Dh. SHUTERIQI, «Uji fle, hasmi s'fle», *Letërsia jonë* nr. 5, 1952, ff. 49-55.

34 Po aty, autori përfshin në recensë edhe vlerësimin për veprat e Kin Dushit e Z. Sakos.

35 Po aty, Cit: «inauguron me sukses në letërsinë tonë novelën; mund të themi se për herë të parë novelës po i hyhet me sukses. »

kështu amputimin dhe daljen nga sistemi letrar të veprave të cilat jo vetëm e kishin inauguruar, por ishin shndërruar në paradigme të këtij lloji;

- së treti, pranimi (qëllimisht) i Gramenos (qoftë edhe me rezervat e shprehura *ka pasur ndonjë provë novele, si fjala vjen nga Gramenoja, veçse puna ka qenë e dobët e ka lënë pak ose aspak gjurmë*) dhe fshirja e emrave të tjerë që ndërtuan traditën e këtij lloji letrar, shkon në hullinë e modelit të pranimit për përjashtim: pranohet Gramenoja, për t'u përjashtuar Konica, Skëndoja, Koliqi, Kuteli e për çudi edhe Migjeni!! që tashmë ishte konfirmuar si i pranuar në "letërsinë e re".

Në funksion të dallimit e kundërvënies duket se janë vendosur edhe përcaktorët "tonë" dhe "e kaluar" që i pranëvendosen termit letërsi në fjalitë: *...libri i Gjatës inauguron me sukses në **letërsinë tonë** novelën*. E fill më pas *Në **letërsinë e kaluar** shqipe ka pasë ndonjë provë novele*". Ndarja është politikisht e justifikuar. Në këtë perspektivë politike mund të shihet edhe përcaktimi "për herë të parë **në gjuhën tonë**, novelës po i hyhet me sukses", ku **në gjuhën tonë** metonimikisht identifikohet ideologjia e instaluar e kohës.

Besojmë se do të paraqiste mjaft interes, po të sillnim në vëmendje debatin për të njëjtën çështje mes Prof Fishtës e V. Koçës në shkrimet që botuan te Gazeta "Tomori i vogël"³⁶, ku i gjithë diskutimi shtrihet në evidentimin e krijuesve që lëvruan dhe shënjuan llojin e novelistikës në letërsi tonë (pa ndarje).

- Trajtesat kritike të Drago Siliqit, nuk rrinë larg në frymë e parime me kërkesat e ideologjisë së kohës e të realizmit socialist, në veçanti kur merret me prerjet tematike e hyn në zbërthimin e motiveve e përmbajtjes së veprave. Por diskursi i tij merr tjetër ngarkesë kur qasja prek shtresat e organizimit dhe gjuhës së tekstit. Evidentimi i problemeve në sistemin e figurave, problemet me ritmin, me ndjeshmërinë poetike, me karakterin deklarativ të vargut e frazat klishe apo gjuhën retorike janë pjesë e diskursit tjetër, atij letrarit, me të cilin Siliqi shfaq prerjen e kritikut që e njëh letërsinë e nuk i ka humbur akoma tërësisht shija e letrares. Të tillë na e shfaqin përcaktimet e mëposhtme që i bëhen poezive të vëllimit "Këngët e dheut"³⁷ të A. Çaçit: *Përveç anës deklarative që përshkon gjithë vjershën, tue mungue pothuajse krejtësisht poetika, ajo që quajmë sensibilitet artistik, kemi në këtë mes përsëritjen e të njëjtës ide pa asnjë nevojë, ajo që thohet në vargun e tretë në mënyrë mjaft vulgare përsëritet në vargun e katërt. ... Retorika e tepërume dhe jo e saktë e përsëritur te e njëjta vepër e damton poezinë ...*³⁸

36 Janë tre shkrime që botohen radhazi te *Tomori i vogël* në numrat 3,4,5, V. 1942.

37 D. SILIQI. «Mbi poezinë e Aleks Çaçit te "Këngët e dheut"», *Nëntori*, v.VI, nr.6/ 1955, f. 39.

38 *Po aty*.

Si njohës i letërsisë, Siliqi do të shfaqet edhe te artikulli “problematic” me titull “Shënime letrare”³⁹, i cili më së shumti është i ndërtuar si kritikë e gjendjes në të cilën ndodhej letërsia e kohës. Duke pranuar në mënyrë eksplicite se letërsia që po zhvillohej nuk ishte ajo që duhej, Siliqi hedh idenë e hapjes së diskutimeve rreth letërsisë, e cila sipas tij vuan nga skematizmi⁴⁰, temat e përcaktuara (*tema e shëndoshë*), e uniformiteti:

Veçanërisht në poezi, tek ne vazhdon të shfaqet mjaft uniformiteti. Shumë poetë shkruajnë njësoj, pak dallohet një poet nga një tjetër. Vjershat shpesh janë të randueme nga deklarata dhe përgjithësime...

*Mendoj se duhet të jemi më ekzigjente për të kërkuar nga secili shkrimtar vetëm vepra me frymëzim e të ngritura në art. Nuk duhet pa më tema e shëndoshë, parim ky që ka ekzistuar me të drejtë për një kohë të gjatë te ne, kohë që mund ta quajmë transitore në tematikën e re.*⁴¹

- Një tjetër model është diskursi i përdorur te recensionet që iu bënë veprave të përkthyer, të konsideruara si modele shkrimi të metodës së realizmit socialist. Në këto recensione evidentohet rëndësia e përkthimit të veprave të tilla, jo për vlerat artistike që ato mbartnin, po për faktin se sillnin tema të përafërta me çfarë po zhvillohej në Shqipërinë e pas '45: me frymën e ndërtimit të rendit e të “njeriut të ri”, me fshatin, me luftën e klasave, me indoktrinimin e njerëzve.

Recensioni i Shuteriqit për romanin “Si u kalit çeliku” të Ostrovskit⁴² shoqërohet nga një diskurs, që përafrohet me atë të retorikës militare të agjitacionit. Në të gjithë recensionin ka një patos agjitativ, të cilit i mungon plotësisht diskursi letrar. Njësitë e mëposhtme veç sa e ilustrjnë këtë frymë: “ajo që e bën kaq të rrallë këtë vepër madhore të letërsisë sovjetike ... është brumi i ngjeshur me gjak njeriu, me heroizmin e rrallë të individit të ri sovjetik, të bolshevikut ... e të tërë një klase. Është klasa e proletariatit që fiton revolucionin, dërrmon kundrarevolucionin, shpartallon ndërhyrjen e armiqve të jashtëm, imperialistë, dhe e “kalitur” në këtë farkë gjigante, niset për luftën e re – ngritjen e socializmit”⁴³. Po ashtu edhe recensionin i Andrea Varfit për romanin “Tokat e çara” të Shollohovit⁴⁴, është një tjetër ilustrues i kësaj fryme. Vepra konsiderohet nga Varfi si “model nga më të mirët për trajtim temash analoge të vendit tonë”. Diskursi i analizës në këtë recension është thellësisht ideologjik, askund nuk thuhet asgjë për karakterin letrar të veprës. Përkundrazi, duke u përqendruar te “platforma

39 D. SILIQI, «Shënime letrare», *Nëntori*, f. 103. Viti???

40 *Kjo është e meta kryesore e shumë vjershave që botohen ne revista e gazeta...*, po aty, f. 105.

41 Po aty.

42 Dh. SHUTERIQI, «Si u kalit çeliku», *Literatura jonë*, mars, 1947, f. 74

43 Po aty.

44 A. VARFI, «M. Shollohov: Tokat e Çara-roman», *Literatura jonë*, 1949, f. 45.

e konfliktit” që zhvillon romani, autori i recensës evidenton me një ligjërim ideologjik se vepra përçon “luftën në mes mbeturinave të botës së vjetër kulake dhe lëvizjes kolektivizonjëse”⁴⁵. Pa diskutim, ky ligjërim ia mbyll dyert qasjes ndaj elementeve letrare të veprës.

I tillë do të jetë edhe në vazhdim diskursi i trajtesës mbi letërsinë. Sanksionimi i metodës së realizmit socialist si i vetmi drejtim që duhet të ndiqte letërsia shqipe brenda kufijve, do ta varfëronte edhe më shumë studimin e letërsisë, e mbi të gjitha dëmin e madh do ta vuante krijimi letrar.

Duke analizuar këtë situatë në të cilën ndodhej letërsia, Camaj në paragrafin përmbyllës të punimit “Nëpër fletët e *Nëndorit*” shtron pyetjen “tue ardhë ne skaj ... pyesim punëtorët e lidhjes së shkrimtarëve dhe artistëve: tue ndjekë kët drejtim a janë të bindun se kanë me qitë diçka të vlefshme në dritë që të mbesë për meritat e veta estetike në letërsinë shqipe?”⁴⁶ Camaj, krijues e studiues par exellance, e kishte përgjigjen qysh atëherë.

Përfundime

Analiza e zhvilluar në këtë punim dëshmon se pas vitit 1945 diskursi letrar shqiptar kaloi një proces metamorfoze të thellë, ku ligjërimi estetik u nënshtua dhe u zëvendësua nga ligjërimi ideologjik. Duke përdorur konceptin e Bourdieut-së për fushën kulturore dhe atë të Althusser-it për aparatet ideologjike të shtetit, vërehet se autonomia relative e fushës letrare u tkurr dhe u komprometua, ndërsa kritika letrare u shndërrua në një instrument të drejtpërdrejtë të edukimit ideologjik.

Ky transformim nuk ndodhi vetëm përmes censurës zyrtare, por edhe nëpërmjet mekanizmave më të imët të autocensurës, të cilët e shndërruan procesin krijues në një disiplinë të brendshme. Shkrimtari dhe kritiku letrar nuk funksiononin më si subjekt estetik autonom, por si agentë kulturorë të integruar në aparat politik, i cili prodhonte diskurse të pranueshme për ideologjinë sunduese.

Si pasojë, fusha letrare u homogjenizua dhe u reduktua në një hapësirë të kontrolluar nga instancat politike, ku kritika humbi funksionin e saj plural dhe u shndërrua në një monolog ideologjik. Megjithatë, në nëntekst, letërsia shpesh ruante gjurmë të një diskursi të dytë, të kuptueshëm vetëm për lexuesin e vëmendshëm. Ky dualitet dëshmon për rezistencën e brendshme të autorëve ndaj imponimit ideologjik dhe për kompleksitetin e marrëdhënies midis letërsisë dhe pushtetit.

45 «...qëllimi i ardhjes së tij (heroit pozitiv): dërgohet nga Partia që të ndihmojë në realizimin e kolektivizimit të lotë dhe në likuidimin e kulakëve si klasë. Dy njerëz: përfaqësorjës të dy botëve në luftë për jetë a vdekje...» po aty.

46 M. CAMAJ. «*Nëpër fletët e “Nëndorit” ...*», revista *Shejzat*, nr. 2-3, 1958.

Në këtë kuptim, rasti shqiptar kontribuon në debatin më të gjerë mbi rolin e letërsisë në sisteme të mbyllura ideologjike, duke treguar se letërsia, edhe kur vihet nën kontroll të plotë, mbetet një hapësirë tensioni midis imponimit dhe krijimit, midis monologut ideologjik dhe dialogut të fshehur estetik.

BIBLIOGRAFI

- [XX]. «Vepra reaksionare e Fishtës.» *Letërsia jonë* IV.2 (1950): 42-49.
- ALTHUSSER, Louis. *Ideology and Ideological State Apparatuses (Notes towards an Investigation)*. In *Lenin and Philosophy and Other Essays*, B. Brewster, Trans., Monthly Review Press, 1971
- ASHTA, Kolë. «Çashje mbi çashtje.» *Shkëndija* Mars 1943, bot. i III: 1-3.
- . «Për një kritikë të poezisë.» *Drita* 12 Janar 1939: 3.
- BALA, Muhamet. «A kemi një dram modern shqiptar.» *Kultura islame* Kallnuer-Shkurt 1942.
- BOURDIEU, Pierre. *The Field of Cultural Production: Essays on Art and Literature*. Columbia University Press. Columbia: Columbia University Press, 1993.
- . *The Rules of Art; Genesis and Structure of the Literary Field*. Përkth. Susan Emanuel. California: Stanford University Press, 1996.
- CAMAJ, Martin. «Nëpër fletët e “Nëndorit” ...» *Shejzat* 2-3 (1958).
- ÇIKA, Nebil. «Ç’është e bukura ose ç’është bukurija?» *Bashkimi i kombit* 25 qershor 1944.
- . «Natyra dhe cilësitë e bukurisë.» *Bashkimi i kombit* 1 Korrik 1944.
- . «Rreth kuptimit të Bukurisë (Ç’është bukurija?)» *Bashkimi i kombit* 28 qershor 1944.
- DARNTON, Robert. *Censors at Work: How States Shaped Literature*. London: W.W.Norton, 2015.
- DRINI, Lek. «Arti si përpjekje. Lodra dhe endëra·(Rreth artit).» *Tomori* 13 janar 1942.
- . «Futurizmi dhe kujtimi.» *Tomori* 23 janar 1942.
- . «Kujtimi element i parë i artit.» *Tomori* 28 janar 1942.
- . «Si shikon poeti (studime estetike).» *Tomori* 7, 10, 17 korrik 1942.
- FISHTA, Filip. «Edhe pak fjalë për “talente letrare në fuqi”.» *Tomori i vogël* 15 mars 1942.
- . «Fytyra letrare të Shqipnisë: Henelau. Kolë Mirdita.» *Tomori i vogël* 1 mars 1942.
- . «Libra që duhen mbledhë e botue ashtu si janë.» *Tomori i vogël* 1 prill 1942.

- . «Talente letrare në fuqi.» *Tomori i vogël* 15 shkurt 1942.
- KOÇA, Vangjel. «Kritika apo diçka tjetër (kritika letrare).» *Tomori i vogël* 15 mars 1942.
- . «Novela dhe novelistët shqiptarë (Përgjigje prof. Filip Fishtës).» *Tomori i vogël* 15 mars 1942.
- KOLIQI, Ernest. «Malli i shtampës.» *Shkëndija* 1940: 25-27.
- KUQALI, Tefë. ««Problema t'ona letrare»,» *Tomorri i vogël* 1942: 5.
- LILI, Jani. «Shënime kritike/ të dy rrymat.» *Fashizmi* dhjetor 1939.
- LUKÁCS, György. *The Meaning of Contemporary Realism*. Merlin Press, 1969.
- «Mendime mbi letërsinë.» *Tomorri* gusht 1940.
- PIPA, Arshi. *Contemporary Albanian Literature*. Vëll. i East European monographs ; no. 305. New York: Columbia University Press, 1991.
- . «Kritikë a polemikë ; Për një kritikë letrare.» *Shkëndija* 1941: 59-61.
- PODGORICA, Fadil. «Për një sistem të kritikës letrare.» *Fryma* 6 (1944): 241-245.
- «Poezia- Proza.» *Fashizmi* shkurt 1940: 3.
- SHUTERIQI, Dhimitër. « Si u kalit çeliku.» *Literatura jonë* (1947): 74.
- . «Arti i Migjenit.» *Përpyekja shqiptare* 18-24 dhjetor 1938: 399-402.
- . «Migjeni (1938 - 1948).» *Literatura jonë* II.8 (1948): 1-44.
- . «Uji fle, hasmi s'fle; (recension për vepën e Fatmir Gjatës).» *Letërsia jonë* VI.5 (1952): 49 - 55.
- SILIQI, Drago. «Mbi poezinë e Aleks Çaçit te "Këngët e dheut".» *Nëntori* VI.6 (1955): 39.
- VARFI, Andrea. «M. Shollohov:-Tokat e Çara-roman.» *Literatura jonë* (1949): 45.
- ZHDANOV, Andrei *On Literature, Music and Philosophy*. Foreign Languages Publishing House, 1950.

